



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr. 475, datë 13.09.2023

MBI

**RISHPËRNDARJEN (TRANSFERIMIN) E FONDEVE BUXHETORE NË
PROGRAMIN 03310, SHPENZIME KORRENTE, PËR VITIN BUXHETOR 2023**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitin 2023”, VKM nr. 437, datë 19.7.2023 “Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rishpërndarjes (transferimit) të fondeve buxhetore, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente (600, 601, 602, 606), për vitin buxhetor 2023, sipas pasqyrave nr. 1, dhe nr. 2, bashkëlidhur.
2. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Pasqyra e
rishpërndarjes (transferimit) të fondeve buxhetore ne shpenzime korrente, (të gjykatave
të mbyllura), programi 03310, viti 2023

në lekë

<i>Pakësohen</i>					
Nr.	Emërtimi	Shpenzime korrente			
		600	601	602	606
01	Gjykata Administrative Shkalla Pare Durres	718,597	34,403	1	-
02	Gjykata Administrative Shkalla Pare Gjirokaster	14,682	284,378	4,850	1,528
03	Gjykata Administrative Shkalla Pare Vlore	499,980	503,099	24,714	-
	Totali	1,233,259	821,880	29,565	1,528
<i>Shtohen</i>					
Nr.	Emërtimi	Shpenzime korrente			
		600	601	602	606
01	Këshilli i Lartë Gjyqësor (03310)	1,233,259	821,880	29,565	1,528
	Totali	1,233,259	821,880	29,565	1,528